



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

Këshilli Drejtues i Odës së Stomatologëve të Kosovës (OSK-së) në mbështetje të vendimit nr.937 të dt. 14.5.2019 të Kuvendit të OSK-së (në vazhdim Oda) për **AUTORIZIMIN** e Këshillit Drejtues për nxjerrjen e akteve normative,- Caktimi i lartësisë së taksave administrative në OSK në mbledhjen e mbajtur me 08.07.2019, mori:

V E N D I M

**PËR CAKTIMIN E PËRKOZHSHËM TË LARTËSISË SË TAKSAVE
ADMINISTRATIVE NË OSK**

I. Taksat administrative për anëtarësim

Të gjithë anëtarët e Odës për rrethanat e mëposhtme janë të obliguar të paguajnë taksat administrative si në vijim:

1. Për regjistrim në regjistrin e anëtarëve të Odës, në shumën prej 5.00 €
2. Për regjistrim të anëtarësisë vjetore prej 50.00 € për të gjithë stomatologët e vendit.
3. Për regjistrim të anëtarësisë vjetore prej 100.00 € për stomatologët e huaj që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Kosovës;
4. Për reregjistrimin e dytë në regjistrin e anëtarësisë së Odës, në rastin kur është larguar nga regjistri i anëtarësisë pas shqiptimit të masës disiplinore, në shumën prej 100.00 €.
5. Për aplikim për ndërrim të kartelës për shkak të ndërrimit të statusit profesional apo për shkak të humbjes, dëmtimit të kartelës së anëtarësisë së Odës në shumën prej 5.00 €.

II. Taksat administrative për licencim dhe rilicencim

1. Taksa administrative për valorizimin e pikëve akredituese në shumë prej 5.00 €.
2. Taksa administrative për dhënie të licencës së punës në shumë prej 100.00 € për kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve;
3. Për ekzemplarë të dublikimit të licencës së punës në shumën prej 15.00 €;
4. Për lëshim të faksimilit në shumën prej 15.00 €.

III. Taksa administrative për organizim të eventeve të ndryshme

1. Taksa administrative për aplikim të organizimit të eventeve të ndryshme profesionale në shumë prej 200.00 €.
2. Për çdo certifikatë të lëshuar 10 % e vlerës së kuotizimit të eventit, në llogari të Odës.

IV. Taksat administrative në procedurën e mbikqyrjes etike

1. Për lëshimin e certifikatës për të kaluarën etike për përdorim brenda vendit në shumën prej 5.00 €.
2. Për lëshimin e certifikatës për të kaluarën etike për përdorim jashtë vendit në shumën prej 30.00 €.
3. Taksat sipas pikës 1 dhe 2 janë të vlefshme në afat kohor prej 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit të certifikatës (vërtetimit).

V. Taksat e përgjithshme administrative

Për nevojat personale të anëtarëve të OSK-së lidhur me lëshimin e dokumenteve të ndryshme, përcaktohen taksat administrative si në vijim:

1. Për dokumente dhe çertifikatat e lëshuara për përdorim brenda Republikës së Kosovës në shumë prej 5 €;
2. Taksa administrative për dokumente dhe çertifikata të lëshuara për përdorim jashtë territorit të Republikës së Kosovës në shumë prej 25.00 €.

VI. Taksat administrative për dhënien e lejës për hulumtime bio-mjekësore

I. Aplikuesit për dhënien e lejit për hulumtime bio-mjekësore, persona fizik apo juridik, do të jenë të obliguar që të paguajnë taksën administrative si në vijim:

1. Për anëtarë të OSK-së, qytetar të Republikës së Kosovës në shumën prej 100.00€;
2. Për jo-anëtarë të OSK-së, qytetarë të Republikës së Kosovës në shumën prej 350.00€;
3. Për qytetarë jo-kosovar, dhe jo-anëtarë të OSK-së në shumën prej 400.00€;
4. Për persona juridik organizata jo-profesionale të regjistruara në Republikën e Kosovës në shumën prej 150.00€
5. Për persona juridik organizata profitabile të regjistruara në Republikën e Kosovës në shumë prej 400.00€
6. Për persona juridik organizata ndërkombëtare që nuk janë të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe nuk janë në mardhënie partneriteti me njësitë e qeverisë së Kosovës në shumën prej 350.00€.

II. Organi kompetent i cili lejon hulumtimin, cakton taksën administrative varësisht nga kategoria e përcaktuar me paragrafin I të këtij neni.

VII. Zbatimi i taksave administrative

1. Taksa administrative për iniciimin e procedurës së licencimit dhe rilicencimit nuk kthehet në rast të refuzimit të licencimit apo rilicencimit.
2. Me rastin e dhënies së licencës, shuma e taksës së paguar për incim të procedurës do të llogaritet në totalin e taksës administrative për lëshimin e licencës së punës.

VIII. Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat e mëhershme që kanë përcaktuar lartësinë e taksave administrative të Odës.
2. Ky vendim do të jetë i zbatueshëm deri në miratimin e të njejtës nga Kuvendi në një nga mbledhjet e ardhshme të Kuvendit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas miratimit të tij nga Këshilli Drejtues i Odës.

Prishtinë,
08.07.2019



Kryetari i OSK-së

Prof. Dr. Blerim Kamberi